



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.2

19 janar

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Rezolutë e Kuvendit datë 18.1.2010	Për gjendjen e emergjencës në qarkun e Shkodrës dhe masat e marra nga qeveria për përballimin dhe normalizimin e situatës 9
Dekret nr.6378 datë 12.1.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare 10
Vendim i KM nr.4, datë 7.1.2010	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal, për periudhën 2011-2013 11
Vendim i KM nr.5, datë 7.1.2010	Për realizimin e shërbimit financiar të vlerësimit të riskut të vendit 15
Urdhër i MBUMK dhe MD nr.2, datë 6.1.2010	Për këmbimin e dokumentacionit dhe të informacionit ndërmjet zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe seksioneve të administrimit dhe mbrojtjes së tokës në këshillat e qarqeve 16
Kërkesë e MPPTT nr.216, datë 14.1.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Himarë e Vjetër-Potam” 18
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetases Gazie Fida..... 19
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Zeqir Ismaili 19

REZOLUTË

PËR GJENDJEN E EMERGJENCËS NË QARKUN E SHKODRËS DHE MASAT E MARRA NGA QEVERIA PËR PËRBALLIMIN DHE NORMALIZIMIN E SITUATËS

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i mbledhur sot, në datën 18.1.2010, në një seancë të posaçme informimi dhe debati për gjendjen emergjencës në qarkun e Shkodrës:

Pasi u njoh në detaje me:

1. Fatkeqësinë e rëndë natyrore dhe gjendjen e emergjencës së krijuar prej saj të ditëve të fundvitit 2009 dhe ditëve të para të vitit 2010;

2. Masat e marra dhe përpjekjet e bëra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, strukturat ekzekutive dhe ato të pushtetit vendor të qarkut të Shkodrës për përballimin e përmbytjes dhe normalizimin e situatës;

3. Menaxhimin profesional dhe të përkushtuar të situatës hidrike në kaskadën e Drinit nga ana e strukturave të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare;

4. Si dhe shembujt e çmuar të ndihmës dhe të solidaritetit njerëzor me banorët e zonave të përmbytura;

Falënderon dhe shpreh mirënjohjen për qytetarët e Shkodrës dhe të Nënshkodrës për kurajën dhe fisnikërinë e treguar gjatë gjithë ditëve të vështira të emergjencës së krijuar nga përmbytja.

Vlerëson përpjekjet maksimale të Qeverisë dhe të Komitetit Ndërmintor për Gjendjen e Emergjencës në Shkodër, nivelin e lartë të gatishmërisë së treguar, si dhe koordinimin e shkëlqyer që kanë realizuar.

Shpreh konsideratën për rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore dhe anëtarët e këshillave bashkiakë dhe komunalë në qarkun e Shkodrës.

Shpreh mirënjohjen e thellë për ndihmën dhe kontributin e sinqertë në njerëz, pajisje dhe ndihmë monetare që kanë dhënë vendet fqinje dhe mike: Italia, Franca, Austria, Greqia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Turqia, Sllovakia, Moldavia etj., si dhe organizmat ndërkombëtarë: NATO-ja, Komisioni European, Banka Botërore dhe PNUD-i.

Falënderon qytetarët shqiptarë për solidaritetin njerëzor, komunat dhe bashkitë e Shqipërisë për mbështetjen e pashembullt institucionale, deputetët e Kuvendit, kompanitë e biznesit, vendase dhe të huaja, për ndihmën thelbësore dhe të menjëhershme, nëpunësit dhe përfaqësuesit e institucioneve dhe enteve të pavarura për kontributet e çmuara, si dhe bashkësitë shqiptare në botë për ndihmën bujare.

Vendosi:

1. T'i kërkojë Qeverisë që të angazhojë të gjitha burimet financiare dhe njerëzore të saj për kapërcimin sa më të shpejtë të të gjitha pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore.

2. T'i kërkojë Qeverisë të ndërmarrë të gjitha masat për vlerësimin real dhe objektiv, si dhe zhdëmtimin e plotë të të gjithë qytetarëve dhe familjeve të prekura dhe dëmtuara nga përmbytja.

3. Qeveria, ministritë dhe të gjitha agjencitë e vendit të nisin menjëherë punën për rehabilitimin e zonës së prekur, pastrimin mjedisor të saj, normalizimin sa më të shpejtë të jetës së njerëzve dhe veprimtarisë së tyre në këto zona.

4. Qeveria të përparësojë të gjitha projektet që i japin zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive të ngjashme natyrore.

5. Rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor rregullator, në përputhje me standardet europiane në fushën e parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive natyrore.

18 janar 2010

DEKRET
Nr.6378, datë 12.1.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|--|
| 1. Violeta Osman Nielsen (Kurti) | 19. Arben Ded Frroku |
| 2. Juljan Nevjon Hoxha | 20. Pëllumb Jakup Mamaj |
| 3. Leidi Sotir Budina | 21. Florjan Pëllumb Mamaj |
| 4. Entela Kostandin Shindre | 22. Renato Pëllumb Mamaj |
| 5. Armando Aranit Çela | 23. Gabriel Pëllumb Mamaj |
| 6. Steve Durim Bajrami | 24. Sonila Andon Mittelstedt (Lika) |
| 7. Emiljano Stefan Resulaj | 25. Mikel Fatmir Lazo |
| 8. Alma Muharem Wendt (Herri) | 26. Aleksandër Pal Bibaj |
| 9. Lirian Abas Beqiraj | 27. Dhurata Ramazan Zaja |
| 10. Xhuliano Lirian Beqiraj | 28. Dëfrim (Defrim) Eqrem Hallulli |
| 11. Luljeta Bajram Pfitzenmayer (Rizvani) | 29. Alexander Dëfrim Hallulli |
| 12. Mirlinda Sotir Binaj (Konçi) | 30. Adriatik Haki Tusha |
| 13. Denise Ardian Binaj | 31. Fabjon Ilir Hoxhaj |
| 14. Bashkim Aqif Qoku | 32. Eda Skënder Döpking (Pashko) |
| 15. Enkelejd Haxhi Dibra | 33. Daniela Bashkim Heller (Ajasllari) |
| 16. Arba Mendel Janzhoff (Kosturi) | 34. Adrian Bexhet Shehu |
| 17. Hajrije Mehmet Prengjoni (Hoxha) | 35. Klaid Pëllumb Shahini |
| 18. Darwin Alush Prengjoni | 36. Stiv Roland Floqi |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.4, datë 7.1.2010

PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL,
PËR PERIUDHËN 2011-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik dhe të treguesve fiskalë, për periudhën 2011-2013, sipas lidhjes nr.1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë” dhe lidhjeve nr.2 e nr.2.1 “Treguesit fiskalë, sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për detajimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre dhe paraqitjen e tyre në Komitetin e Planifikimit Strategjik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja Nr. 1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
				Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	3.16	3.17	3.18	3.19	3.21	3.22	3.23
Inflacioni (mesatar)	%	2.9	3.4	2.2	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	3.9	3.5	2.3	3.1	3.1	3.0	3.1
Rritja reale e PBB	%	6.0	8.0	3.0	5.5	6.5	7.1	6.7
Rritja nominale e PBB	%	10.1	11.8	5.3	8.7	9.7	10.3	10.1
PBB	Lek miliardë	971.2	1085.7	1143.4	1242.8	1363.5	1503.4	1654.6
PBB për banor	Lek mijë	307.2	342.7	359.0	389.0	425.3	467.3	512.5
Norma e papunësisë	%	13.2	12.7	12.7	12.1	10.8	9.7	8.6
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-26.7	-26.7	-24.7	-23.3	-21.7	-21.2	-19.9
Mallra	% të PBB	-26.8	-27.5	-26.3	-25.3	-24.4	-23.6	-22.9
Rritja e eksporteve	%	25.5	15.6	-12.0	18.0	16.7	16.0	14.0
Rritja e importeve	%	27.1	14.8	-2.7	7.8	8.8	9.3	9.1

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, Banka e Shqipërisë

Lidhja nr.2

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne milion Leke

Nr.	E M E R T I M I	2008	2009	2010	2010	2011	2012	2013
			I Pritshmi	Buxheti	I Pritshmi	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	291,238	301,725	360,955	330,565	365,124	405,069	448,065
I.	Ndihmat	4,228	5,313	7,776	6,310	6,370	6,848	6,925
II.	Te ardhura tatimore	264,421	273,590	328,729	304,022	337,753	376,207	418,086
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	205,292	211,419	246,036	232,174	256,670	285,239	316,718
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	107,094	110,085	126,889	120,213	132,380	146,863	162,925
2	Tatimi mbi Fitimin	18,108	17,208	19,375	19,664	22,156	24,937	28,013
3	Akcizat	32,510	33,895	41,669	37,392	41,563	46,341	51,567
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	24,498	27,338	33,862	29,923	33,116	36,757	40,737
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	14,423	15,081	16,520	16,649	18,485	20,641	23,004
6	Taksa Doganore	8,660	7,812	7,721	8,332	8,969	9,701	10,471
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	11,307	12,341	20,948	15,479	18,008	20,816	23,473
II.2	Te ardhura nga fondet speciale	47,822	49,830	61,745	56,369	63,075	70,152	77,896
1	Sigurimi Shoqeror	42,547	44,498	53,757	49,088	55,076	61,395	68,310
2	Sigurimi Shendetesor	5,275	5,332	6,588	5,882	6,599	7,356	8,185
3	Te ardhurat per kompensimin ne Vlere te Pronareve			1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
III.	Te ardhura jotatimore	22,588	22,822	24,450	20,233	21,001	22,014	23,054
	TOTALI I SHPENZIMEVE	351,492		410,721	380,331	408,135	449,523	497,130
I.	Shpenzime Korrente	250,298		319,430	308,820	328,364	359,431	395,363
I.1	Personeli	66,621		67,655	67,654	69,744	72,218	75,628
1	Paga	55,983		56,217	56,217	57,904	59,641	61,430
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	10,637		8,417	8,417	8,670	8,930	9,197
3	Politika te reja pagash			3,020	3,020	3,171	3,647	5,000
I.2	Interesat	31,307		43,535	43,536	49,465	53,095	56,133
1	Te brendshme	28,386		35,796	35,796	36,300	40,500	44,800
2	Te Huaja	2,921		7,740	7,740	13,165	12,595	11,333
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	28,788		37,272	32,272	33,169	38,366	47,877
I.4	Subvencionet	2,555		1,935	1,935	2,000	2,000	2,000
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	76,199		110,268	110,268	116,586	127,103	140,962
1	Sigurime Shoqerore	65,823		79,519	79,519	84,919	90,119	98,119
2	Politika te reja pensionesh			2,700	2,700	2,600	4,000	6,000
3	Sigurime Shendetore	10,376		25,949	25,949	26,467	28,584	31,443
4	Shpenzime per kompensimin ne vleren te pronareve			2,100	2,100	2,600	4,400	5,400
I.6	Buxheti lokal	27,079		38,223	31,486	35,580	41,749	46,763
2	Buxheti lokal (Granti)	15,772		17,275	16,008	17,572	20,933	23,290
3	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	11,307		20,948	15,479	18,008	20,816	23,473
I.7	Shpenzime te tjera	17,750		20,542	20,542	21,820	24,900	26,000
1	Pagesa e papunesise	825		900	900	900	900	1,000
2	Ndihma Ekonomike	15,925		16,642	16,642	16,920	18,000	19,000
3	Kompensim per te perndjekurit politike	1,000		2,000	2,000	3,000	5,000	5,000
4	Kompensim per energjin elektrike	0		1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
II.	Fondi Rezerve	0		5,230	5,230	12,200	13,644	14,957
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave			2,500	2,500	3,000	3,500	3,500
2	Fondi Kontigjence per ruajtjen e deficitit			2,730	2,730	9,200	10,144	11,457
III.	Shpenzime Kapitale	93,783		86,062	67,409	67,571	76,448	86,810
1	Financimi Brendshem	50,046		59,471	38,599	32,576	46,800	60,385
2	Financimi Huaj	43,587		26,591	28,810	34,995	29,648	26,425
IV	Transferta te ndryshme	7,411		0	0	0	0	0
	DEFICITI	-60,254		-49,766	-49,766	-43,012	-44,454	-49,066
	FINANCIMI DEFICITIT	60,254		49,766	49,766	43,012	44,454	49,066
	Brendshem	24,417		39,612	35,926	24,478	58,834	41,177
	Te ardhura nga Privatizimi	5,538		300	300	300	300	300
	Hua-marje e brendeshme	18,012		39,312	35,626	24,178	58,534	40,877
	Te tjera	866		0	0	0	0	0
	I Huaj	35,837		10,155	13,840	18,534	-14,380	7,889
	Hua afatgjate(e marre)	39,794		18,815	22,500	28,625	22,800	19,500
	Ndryshimi i gjendjes se arkes	292		0	0	0	0	0
	Ripagesat	-4,248		-8,660	-8,660	-10,091	-37,180	-11,611
Memo:								
	Borxhi Publik Total	595,780	679,964	739,931	739,931	793,142	837,296	893,490
	Borxhi publik i buxhetit qendror	595,780	679,964	729,431	729,431	772,142	816,296	865,062
	I Brendshem	400,456	415,351	454,664	450,978	475,156	533,690	574,567
	I Huaj	195,324	264,613	274,768	278,453	296,987	282,607	290,496
	Borxhi publik hipotetik jashte treguesve fiskal	0	0	10,500	10,500	21,000	21,000	28,428
	PBB nominal	1,085,674	1,143,373	1,242,760	1,242,760	1,363,543	1,503,374	1,654,611

Burimi: Ministria e Financave

Lidhja Nr. 2/1

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR

ne % te PBB

Nr.	E M E R T I M I	2008	2009	2010	2010	2011	2012	2013
			I Pritshmi	Buxheti	I Pritshmi	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	26.8	26.4	29.0	26.6	26.8	26.9	27.1
I.	Ndihmat	0.4	0.5	0.6	0.5	0.5	0.5	0.4
II.	Te ardhura tatimore	24.4	23.9	26.5	24.5	24.8	25.0	25.3
II.1	Nga Tatimet dhe doganat	18.9	18.5	19.8	18.7	18.8	19.0	19.1
1	Tatimi mbi vleren e Shtuar	9.9	9.6	10.2	9.7	9.7	9.8	9.8
2	Tatimi mbi Fitimin	1.7	1.5	1.6	1.6	1.6	1.7	1.7
3	Akcizat	3.0	3.0	3.4	3.0	3.0	3.1	3.1
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	2.3	2.4	2.7	2.4	2.4	2.4	2.5
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1.3	1.3	1.3	1.3	1.4	1.4	1.4
6	Taksa Doganore	0.8	0.7	0.6	0.7	0.7	0.6	0.6
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	1.0	1.1	1.7	1.2	1.3	1.4	1.4
II.2	Te ardhura nga fondet speciale	4.4	4.4	5.0	4.5	4.6	4.7	4.7
1	Sigurimi Shoqeror	3.9	3.9	4.3	3.9	4.0	4.1	4.1
2	Sigurimi Shendetesor	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
3	Te ardhurat per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
IV.	Te ardhura jotatimore	2.1	2.0	2.0	1.6	1.5	1.5	1.4
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32.4		33.0	30.6	29.9	29.9	30.0
I.	Shpenzime Korrente	23.1		25.7	24.8	24.1	23.9	23.9
I.1	Personeli	6.1		5.4	5.4	5.1	4.8	4.6
1	Paga	5.2		4.5	4.5	4.2	4.0	3.7
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	1.0		0.7	0.7	0.6	0.6	0.6
3	Politika te reja pagash	0.0		0.2	0.2	0.2	0.2	0.3
I.2	Interesat	2.9		3.5	3.5	3.6	3.5	3.4
1	Te brendshme	2.6		2.9	2.9	2.7	2.7	2.7
2	Te Huaja	0.3		0.6	0.6	1.0	0.8	0.7
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	2.7		3.0	2.6	2.4	2.6	2.9
I.4	Subvencionet	0.2		0.2	0.2	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	7.0		8.9	8.9	8.6	8.5	8.5
1	Sigurime Shoqerore	6.1		6.4	6.4	6.2	6.0	5.9
2	Politika te reja pensionesh	0.0		0.2	0.2	0.2	0.3	0.4
2	Sigurime Shendetesore	1.0		2.1	2.1	1.9	1.9	1.9
4	Shpenzime per kompensimin ne vlere te pronareve	0.0		0.2	0.2	0.2	0.3	0.3
I.6	Buxheti lokal	2.5		3.1	2.5	2.6	2.8	2.8
2	Buxheti lokal (Granti)	1.5		1.4	1.3	1.3	1.4	1.4
3	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	1.0		1.7	1.2	1.3	1.4	1.4
I.7	Shpenzime te tjera	1.6		1.7	1.7	1.6	1.7	1.6
1	Pagesa e papunesise	0.1		0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Ndihma Ekonomike	1.5		1.3	1.3	1.2	1.2	1.1
3	Kompensim per te permdjekurit politike	0.1		0.2	0.2	0.2	0.3	0.3
4	Kompensim per energjin elektrike	0.0		0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi Rezerve	0.0		0.4	0.4	0.9	0.9	0.9
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0.0		0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
2	Fondi Kontigjence per ruajtjen e deficitit	0.0		0.2	0.2	0.7	0.7	0.7
III.	Shpenzime Kapitale	8.6		6.9	5.4	5.0	5.1	5.2
1	Financimi Brendshem	4.6		4.8	3.1	2.4	3.1	3.6
2	Financimi Huaj	4.0		2.1	2.3	2.6	2.0	1.6
IV	Transferata te ndryshme	0.7		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	DEFIÇITI	-5.5		-4.0	-4.0	-3.2	-3.0	-3.0
	FINANCIMI DEFIÇITIT	5.5		4.0	4.0	3.2	3.0	3.0
	Brendshem	2.2		3.2	2.9	1.8	3.9	2.5
	Te ardhura nga Privatizimi	0.5		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Hua-marje e brendeshme	1.7		3.2	2.9	1.8	3.9	2.5
	Te tjera	0.1		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	I Huaj	3.3		0.8	1.1	1.4	-1.0	0.5
	Hua afatgjate(e marre)	3.7		1.5	1.8	2.1	1.5	1.2
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ripagesat	-0.4		-0.7	-0.7	-0.7	-2.5	-0.7
Memo:								
	Borxhi Publik Total	54.9	59.5	59.5	59.5	58.2	55.7	54.0
	Borxhi publik i buxhetit qendror	54.9	59.5	58.7	58.7	56.6	54.3	52.3
	I Brendshem	36.9	36.3	36.6	36.3	34.8	35.5	34.7
	I Huaj	18.0	23.1	22.1	22.4	21.8	18.8	17.6
	Borxhi publik hipotetik jashte treguesve fiskal	0.0	0.0	0.8	0.8	1.5	1.4	1.7

Burimi: Ministria e Financave

VENDIM
Nr.5, datë 7.1.2010

PËR REALIZIMIN E SHËRBIMIT FINANCIAR TË VLERËSIMIT TË RISKUT TË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 7 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin dhe realizimin e procedurës, që do të ndiqet për zhvillimin e procesit të vlerësimit të riskut të vendit (Credit rating), për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

2. Termi “Vlerësim i riskut (Credit rating)” në kuptim të këtij vendimi, përfshin shërbimin financiar në formën e procesit vlerësues të riskut të vendit, duke ofruar shërbimin e nevojshëm për realizimin e procesit të transaksioneve të huamarrjes në tregun ndërkombëtar.

3. Për realizimin e shërbimit financiar, titullari nxjerr urdhrin, në të cilin duhet të përcaktohen, detyrimisht:

a) shërbimi financiar, objekt i kësaj procedure;

b) lista e institucioneve financiare pjesëmarrëse, që do të ofrojnë shërbimin e kërkuar, e cila do të përcaktohet nga komisioni i hartimit të dokumenteve;

c) përbërja dhe emrat e anëtarëve të komisionit të hartimit të dokumenteve dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave, në përbërje të të cilit të jenë kryetari dhe të paktën 2 specialistë të fushës;

ç) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

4. Komisioni i hartimit të dokumenteve, brenda 5 ditëve nga data e nxjerrjes së urdhrit, përgatit ftesën për ofertë, të cilën e dërgon në adresat përkatëse. Në ftesë përcaktohen:

a) institucioni, që kryen procedurën për shërbimin në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi;

b) shërbimin financiar, që kërkohet të realizohet;

c) kushtet e veçanta të kërkuara;

ç) data, ora dhe vendi i paraqitjes së ofertës.

5. Dokumentacioni i paraqitur nga subjektet e interesuara ruhet dhe nuk hapet nga komisioni i vlerësimit të ofertave deri në datën dhe orën e caktuar në ftesën për ofertë.

6. Komisioni i vlerësimit të ofertave, në marrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e subjektit, bazohet, respektivisht në:

a) plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe teknike;

b) cilësinë e shërbimit të ofruar dhe reputacionin në tregjet financiare më të njohura botërore;

c) çmimin më të ulët për shërbimin e ofruar nga subjektet, për blerjen, shitjen/transferimin e instrumentit financiar.

Rëndësia e secilit prej kriterëve të sipërpërmendura do të përcaktohet në dokumentet e tenderit, gjë për të cilën do të njoftohen institucionet financiare pjesëmarrëse.

7. Titullari i institucionit, në bazë të vendimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave, miraton ose refuzon, brenda 5 ditëve, shpalljen e fituesit.

8. Komisioni i vlerësimit të ofertave, brenda 5 ditëve nga shpallja e fituesit, njofton të interesuarit për klasifikimin përfundimtar të ofertave.

9. Ankesat e subjekteve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, titullarit të institucionit. Vendimi i jepet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës dhe është përfundimtar. Njoftimi përfundimtar i fituesit do të bëhet me të gjitha mjetet e komunikimit.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr.2, datë 6.1.2010

**PËR KËMBIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT NDËRMJET ZYRAVE
VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE SEKSIONEVE
TË ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS NË KËSHILLAT E QARQEVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 3, 6 dhe 7 të ligjit nr.8752 datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës” dhe pikës 4, 12 dhe 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki”,

URDHËROJMË:

1. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) t’u rikthejnë seksioneve të administrimit dhe mbrojtjes së tokës së qarqeve (SAMT) të gjitha planimetritë kadastrale origjinale, planshetat e hartave kadastrale dhe librat e ngastrave të disponuara prej tyre, të cilat u janë dorëzuar nga ish-zyrat e kadastrës (aktualisht SAMT e qarkut) koordinatorëve të sistemit të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme ose direkt ZVRPP, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit nr.511, datë 1.12.1995 “Për dorëzimin e akteve të pronësisë dhe përdorimit të tokës bujqësore koordinatorëve të rretheve të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për nevoja pune, ZVRPP-të mbajnë fotokopjet e tyre.

Dorëzimi të bëhet me procesverbal dhe të përfundojë brenda muajit qershor 2010.

2. ZVRPP t’i ofrojë SAMT-së së qarkut të gjitha kopjet e hartave treguese të regjistrimit (HTR) dhe librave të ngastrave (LN) në formë elektronike dhe/ose manuale.

Fotokopjimi i HTR-ve dhe LN-ve të bëhet në ambientet e ZVRPP-së, brenda muajit qershor 2010.

3. SAMT-ja e qarkut të caktojë një punonjës të tij, të pajisur me autorizim të kryetarit të këshillit të qarkut për fotokopjimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri sipas kërkesës që bëjnë zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki.

Të gjitha shpenzimet për marrjen e këtij dokumentacioni mbulohen nga buxheti i këshillit të qarkut.

4. ZVRPP-ja e rrethit, sipas formatit të pasqyrës që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe si pjesë përbërëse e tij, brenda datës 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti përgatit evidencën 6-mujore të shitblerjeve të tokës bujqësore (arë, pemëtore, vreshta, ullishte) dhe ia dërgon SAMT-së së këshillit të qarkut.

SAMT e këshillit të qarkut, brenda datës 15 korrik dhe 15 janar të çdo viti, i dërgon MBUMK-së evidencën përmbledhëse, 6-mujore të shitblerjeve të tokës bujqësore.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ZVRPP në rrethe, SAMT në këshillat e qarqeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes
së Konsumatorit
Genc Ruli

Ministri i Drejtësisë
Bujar Nishani

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Evidenca e shtiblerjeve të tokës bujqësore (arë, pemëtore, vreshta, ullishte)

Nr.	Emërtimi i komunës/bashkisë ku është kryer transaksioni i tokës	6-mujori i parë Viti _____				Progresi vjetor Viti _____			
		Nr. i transaksioneve	Sipërfaqja objekt transaksionit m ²	Çmimi mesatar në shkallë komune lekë/m ²	Vlefte lekë	Nr.transaksioneve	Sipërfaqja objekt transaksionit m ²	Çmimi mesatar në shkallë komune lekë/m ²	Vlefte lekë
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									
11									
12									
13									
14									
15									
	GJITHSEJ RRETHI								

KËRKESË
Nr.216, datë 14.1.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Mbështetur në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Himarë e Vjetër-Potam”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim, bëhet vetëm për pasurinë e llojit truall.

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 115 200 (katër milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “HIMARË E VJETËR-POTAM”**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadas trale	Nr. regjistri hipotekar	Sip m ² (truall)	Çmimi	Vlera	Vlera Totale (lekë)	Shënime
1	Katina		Kacelano	1952	1027	92	3200	294400	294400	Vërtetim hipotekor
2	Koste		Dhima	1952	708	839	3200	2684800	2684800	Vërtetim hipotekor
3	Nikollaq		Duko	1952	87	355	3200	1136000	1136000	Vërtetim hipotekor
	Totali					1286		4115200	4115200	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë Dibër, me vendimin nr.742, datë 15.12.2009, vendosi shpalljen të vdekur të shtetases Gazie Fida, e bija e Seferit dhe e Linditës, e datëlindjes 12.5.1994, lindur dhe banuese në Grevë, komuna Melan.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë Dibër, me vendimin nr.741, datë 15.12.2009, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Zeqir Ismaili, i datëlindjes 7.1.1916, lindur dhe banues në Rabdisht, komuna Melan.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 19.1.2010
Doli nga shtypi më 19.1.2010

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 14 lekë